



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Nr. Prot.: 01-463/02-37323

Datë: 18.08.2026

S Q A R I M

Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, lidhur me Njoftimin për pjesëmarrje në Ankand Publik **nr.01-463/02-37323/26** të datës **04.08.2026**, të publikuar në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit me nr. **15-462/01-20088**, të datës **30.04.2026**, jep këtë:

S Q A R I M

Në Njoftimin për pjesëmarrje në Ankand Publik, për dhënie në shfrytëzim në afat prej **3 (tre) vitesh** të pronës së paluajtshme komunale, me sipërfaqe prej **30 m²**, për shkak të një gabimi teknik në formulim, në disa pjesë të njoftimit është përdorur termi **“lokali”** apo **“lokalet”**.

Me këtë sqarim, Komisioni Vlerësues bën të ditur se **objekt i procedurës së dhënies në shfrytëzim është prona e paluajtshme komunale me sipërfaqe prej 30 m²**, e identifikuar në Njoftimin për pjesëmarrje në Ankand Publik me numrin e ngastrës **P-71409044-01952-1**, me adresë në **Rrugën “Shqipëria”, Lipjan, vendi i quajtur “Varosh”**.

Rrjedhimisht, në të gjitha pjesët e Njoftimit ku është përdorur termi **“lokal”** ose **“lokalet”**, ky term duhet të kuptohet si referencë për **pronën e paluajtshme komunale me sipërfaqe prej 30 m²**, e cila është objekt i këtij ankandi publik.

Komuna e Lipjanit **nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi financiare apo detyrim për kompensimin e investimeve të realizuara në këtë pronë** nëse objektet montazhë mbeten në pronë apo çmontohen.

Po ashtu, çdo referencë tjetër në Njoftim ndaj termit **“lokal/lokalet”**, kur i referohet objektit të kësaj procedure, nënkupton **pronën e paluajtshme komunale me sipërfaqe prej 30 m².**

Ky sqarim bëhet me qëllim të eliminimit të çdo paqartësie dhe të saktësisht të terminologjisë së përdorur në Njoftimin për pjesëmarrje në Ankand Publik.


Ky sqarim nuk ndryshon objektin e procedurës, sipërfaqen prej 30 m², numrin e ngastrës, lokacionin, afatin e shfrytëzimit, destinimin, çmimin fillestar apo kriteret e përzgjedhjes në këtë Njoftim për pjesëmarrje në Ankand Publik me nr.01-463/02-37323/26 të datës 04.08.2026.

Të gjitha pjesët e tjera të Njoftimit për pjesëmarrje në Ankand Publik mbeten të **pandryshuara dhe në fuqi.**

Ky sqarim publikohet në të njëjtën mënyrë si Njoftimi për pjesëmarrje në Ankand Publik dhe është pjesë përbërëse e tij.

KRYESUESI I KOMISIONIT VLERËSUES

Valon Pacolli





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR ME: PRIMLJENO DANA: 04.08.2026			
NJËSIA KOMUNALE	NR. KLASIFIKIMIT	NR. LËNDËS SR. PREDMETA	SHTOJCA PRILLOB
01-	463/02-	37323/26	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, neneve 8, 9 dhe 10 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan me nr. 15-462/01-20088 i datës 30.04.2026, dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në zonën kadastrale Lipjan me nr. 15-020/04-20091 të datës 30.04.2026, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës me nr. 15-462/01-20088 të datës 30.04.2026 jep në shfrytëzim në afat prej 3 viteve pronën e cila gjendet në zonën kadastrale Lipjan si vijon:

Nr	Numri i ngastrës	Adresa	Kati	Nr.i lokalit	Sipërfaqja
1.	P-71409044-01952-1	Rruga "Shqipëria" Lipjan, vendi i quajtur "Varosh"		/	30 m ²

Lokali i lartëcekur ipet në shfrytëzim afatshkurtër me qëllim të realizimit të interesit publik përkatësisht krijimin e të hyrave vetanake dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale.

Në pronën e lartë cekur nuk lejohet ndërtimi i objekteve të vrazhda apo të forta por vetëm i objekteve të përkohshme në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores të Kuvendit të Komunës së Lipjanit 15Nr.011-5823 datë 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

V.P.

S.A

S.H.B

X.H. I.

Z.O

Çmimi fillestar për periudhën 3 vjeçare të shfrytëzimit të lokaleve përcaktohet në shumë prej 4.00 € për çdo m², në bazë mujore.

Njoftohen personat fizik dhe juridik, të cilët dëshirojnë të konkurojnë me ofertat e tyre për marrje në shfrytëzim të lokaleve të cekura, se hapja e ankandit publik për vlerësimin e ofertave do të mbahet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë 20.08.2026, duke filluar në ora 10:00.

Pagesa e çmimit nga ofertuesi fitues në ankand do të bëhet në pajtim me Kontratën për dhënie në shfrytëzim për periudhën 3 vjeçare të lokalit në 3 këste të barabarta me obligim të pagesës në momentin e nënshkrimit të kontratës për periudhë 1 vjeçare (kësti i parë).

Lokalet do të ipen në shfrytëzim në gjendjen ashtu siç janë në ditën e shpalljes së këtij ankandi, kështu që pas lidhjes së kontratës, kërkesat për riparim të lokaleve dhe stabilimenteve nuk do jenë obligim dhe nuk do të miratohen nga Komuna për zbritjen e çmimit të kontraktuar.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 20 € (njëzet euro)

Aplikuesit mund të konkurojnë për marrjen në shfrytëzim të lokalit të cekur sipas parimit një ofertë për lokal.

Pjesëmarrësve në ankand u garantohet e drejta që të:

1. Të informohen me procedurat e ankandit publik;
2. Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
3. Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
4. Të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre ditë para mbajtjes së ankandit publik.

Konkurimi për pjesëmarrje në Ankand bëhet duke dorëzuar aplikacionin me ofertë në kovertë të mbyllur.

Oferta duhet të përmbajë : shënimet e ofertuesit, numrin e këtij njoftimi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi lokalin për të cilin konkurohet në ankand, çmimin ofertues të shënuar me numër dhe shkronja, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kovertë të mbyllur.

Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

V.P. S.A SH.B XH. I. 2.0

Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të

Komunës së Lipjanit

Pjesëmarrje në Ankand Publik

Tërheqja e aplikacionit (formularit) mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 1 dhe 2.

Aplikacioni (formulari) bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorëzohet brenda afatit prej 15 dite nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi deri në ora 16:00 në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 1 dhe 2.

Ofertat e paprecizuara, të panënshkrura dhe të ofertuara me çmim më të ultë se çmimi fillestar i publikuar me këtë Njoftim nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave në ankand publik marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Komisioni në ankand i bën publike çmimet e ofertuara të secilës ofertë për lokalin përkatës.

Konform nenit 12 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik Komisioni bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më lartë të ofruar në ankand publik.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do ti dërgohet fituesit, do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i tretë Sektori për çështje pronësore-juridike ose në tel 038-200-41-507.

Komisioni:


1. Valon Pacolli

2. Sead Aliu

3. Shefki Bytyqi

4. Xhenetë Mollopolci

5. Zejnije Osmani



Nr. 01-463/02-0037323/26

Me datë: 04.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS

-Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit-

**APLIKACION
PËR PJESËMARRËJE NË ANKAND**

Në bazë të Njoftimit për pjesëmarrje në ankand Nr _____ të datës _____ aplikoj për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër të lokalit në pronësi të Komunës me këto shënime:

Vendi		Hyrja nr	
Ngastra katastrale		Kati	
Rruga		Numri i lokalit	
Numri i ndërtesës		Sipërfaqja	

APLIKUESI – PERSON FIZIK

Emri , Mbiemri dhe numri i telefonit	
Vendbanimi	
Adresa	
Emri dhe mbiemri të autorizuarit	
Numri dhe data e autorizimit	

APLIKUESI – PERSON JURIDIK

Emërtimi i biznesit dhe numri kontaktues	
Selia	
Adresa	
Numri i biznesit	
Përfaqësuesi	
I autorizuari	
Numri dhe data e autorizimit	

Aplikacionit i bashkëngjesë:

- 1.Ofertën në kovertë të mbyllur
- 2.Pagesën e taksës për aplikim.
- 3.Fotokopjen e certifikates mbi regjistrimin e biznesit (për persona juridik)
- 4.Fotokopjen e letërnjoftimit të ofertuesit.

Lipjan, Më datë _____ 2026

APLIKUESI

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

V.P. S.A. JH.B XH.1. 200 1